



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 737/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Afiete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Zize Vrellaku, kandidate për anëtare e Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Zize Vrellaku, kandidate për anëtare e Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me shenjë ZL.Anr.737/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.737/2017 me datën 09.11.2017 në ora 15:25, nga parashtruesja Zize Vrellaku, kandidate për anëtare e Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendohet se në qendrat e votimit si: në QV Shkolla Filllore “Migjeni” në Baincë, në QV Shkolla Filllore “Rasim Kiçina” në Drenas, në QV Shkolla Filllore “Halil Bajraktari” në Drenas, në QV Shkolla Filllore “Ali Gashi” në Çikatovë, në QV Shkolla Filllore “Fehmi Lladrovci” në Drenas, në QV Shkolla Filllore “Zenel Hajdini” në Terstenik, në QV Shkolla Filllore “Shaban Polluzha” në Polluzhë, në QV Shkolla Filllore “Fazli Grajçevci” në Poklek, dhe në QV Shkolla Filllore “Shotë Galica” në Terdevc i mungojnë votat.

Parashtruesja e ankesës si provë nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankueses gjeti se ankuesja me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet në të cilat pretendon se ka pasur parregullsi. Prandaj Paneli ankesën e ankueses e konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankueses e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL.Anr.737/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyllene Sylejmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*